



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS  
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA  
KOSOVA BAR ASSOCIATION**

---

Mbështetur në nenin 41, paragrafi 3, nënparagrafi 3.4 të Ligjit Nr. 04/L-193 për Avokatinë dhe nenin 95, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës, Këshilli Drejtues i Odës, në mbledhjen e mbajtur më 06 mars 2026, miraton këtë:

**RREGULLORE PËR PRANIMIN DHE TRAJTIMIN E THIRRJEVE TELEFONIKE NË  
SISTEMIN E CAKTIMIT TË AVOKATËVE SIPAS DETYRËS ZYRTARE  
(EX OFFICIO)**

**Neni 1  
Qëllimi**

1. Kjo Rregullore përcakton rregullat detyruese për pranimin, trajtimin dhe dokumentimin e thirrjeve telefonike nga Policia, Prokuroria, Gjykatat dhe institucionet e tjera, lidhur me kërkesat për caktimin e avokatëve sipas detyrës zyrtare.
2. Kjo Rregullore ka për qëllim:

- 2.1. garantimin e standardit maksimal profesional në komunikim;
- 2.2. ruajtjen e autoritetit dhe integritetit institucional të OAK;
- 2.3. sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi;
- 2.4. mbrojtjen e kredibilitetit dhe funksionalitetit të sistemit “ex officio”.

**Neni 2  
Baza ligjore**

1. Kjo Rregullore mbështetet në:
  - 2.1. Ligjin për Avokatinë;
  - 2.2. Statutin e Odës së Avokatëve të Kosovës;
  - 2.3. Aktet e brendshme normative të OAK;
  - 2.4. Standardet profesionale dhe etike të ushtrimit të profesionit të avokatit.

**Neni 3  
Fusha e zbatimit**

1. Kjo Rregullore zbatohet për të gjithë zyrtarët e autorizuar për pranimin, administrimin dhe procedimin e kërkesave për caktimin e avokatëve sipas detyrës zyrtare në OAK.

2. Zbatimi i saj është i detyrueshëm dhe i drejtpërdrejtë, pa përjashtim.

#### **Neni 4 Standardi i prezantimit**

1. Gjatë çdo komunikimi telefonik, zyrtari është i detyruar:

- 1.1. të prezantohet si: *“Zyrtar për caktimin e avokatëve sipas detyrës zyrtare në Odën e Avokatëve të Kosovës”*;
- 1.2. të përfaqësojë institucionin dhe jo veten personalisht.

2. Zyrtari nuk është i detyruar të japë emrin personal, përveç në rastet kur kjo kërkohet përmes procedurave zyrtare dhe kanaleve institucionale.

#### **Neni 5 Kërkesa e të dhënave**

1. Për procedimin e kërkesës, zyrtari është i detyruar të kërkojë:

- 1.1. emrin dhe mbiemrin e personit për të cilin kërkohet avokat;
- 1.2. cilësinë procedurale (i dyshuar, i pandehur, i arrestuar, etj.);
- 1.3. veprën penale për të cilën procedohet;
- 1.4. organin procedues dhe kontaktin zyrtar;
- 1.5. fazën procedurale (ndalim, intervistim, seancë, etj.).

2. Këto të dhëna kërkohen ekskluzivisht për:

- 2.1. verifikimin e konfliktit të interesit;
- 2.2. sigurimin e përputhshmërisë me ligjin;
- 2.3. administrimin dhe monitorimin institucional të sistemit “ex officio”.

#### **Neni 6 Refuzimi për dhënien e të dhënave**

1. Refuzimi për dhënien e të dhënave të përcaktuara në këtë Rregullore pamundëson procedimin e kërkesës.

2. Në këtë rast, zyrtari është i detyruar:

- 2.1. të njoftojë qartë palën për pamundësinë e procedimit;
- 2.2. të mos vazhdojë me caktimin e avokatit pa plotësimin e kushteve ligjore.

#### **Neni 7 Standardi i komunikimit**

1. Zyrtari është i detyruar të mbajë:

- 1.1. ton të qetë, formal dhe institucional;
- 1.2. gjuhë të respektueshme dhe neutrale;
- 1.3. qartësi dhe saktësi në komunikim;
- 1.4. vetëkontroll të plotë në çdo rrethanë.

2. Ndalohet rreptësishtë:

- 2.1. ngritja e zërit;
- 2.2. reagimi emocional;
- 2.3. përdorimi i ironisë, nënçmimit apo debateve personale;
- 2.4. refuzimi arbitrar i bashkëpunimit;
- 2.5. çdo sjellje që cenon imazhin dhe autoritetin e OAK.

### **Neni 8**

#### **Sjellja në rast presioni ose sjelljeje të papërshtatshme**

1. Në rast se pala telefonuese ushtron presion, përdor ton urdhërues, përdor gjuhë të papërshtatshme apo në çfarëdo mënyre refuzon bashkëpunimin procedural, zyrtari është i detyruar të ruajë qetësinë dhe qëndrimin institucional, të rikujtojë bazën ligjore të kërkesës për të dhëna, të paralajmërojë për ndërprerjen e komunikimit në rast të vazhdimit të sjelljes së papranueshme.
2. Nëse sjellja vazhdon, të ndërpresë komunikimin në mënyrë të qetë dhe të raportojë menjëherë rastin tek eprori. Reagimi emocional apo personal është i ndaluar.

### **Neni 9**

#### **Regjistrimi dhe dokumentimi**

1. Çdo thirrje:
  - 1.1. regjistrohet sipas procedurave të brendshme;
  - 1.2. dokumentohet në regjistrin zyrtar;
  - 1.3. ruhet për qëllime verifikimi dhe mbikëqyrjeje institucionale.
2. Incizimet përdoren ekskluzivisht për qëllime institucionale dhe disiplinore.

### **Neni 10**

#### **Konfidencialiteti**

1. Të gjitha të dhënat e marra gjatë komunikimit konsiderohen konfidenciale.
2. Zyrtari është i detyruar:
  - 2.1. të mos shpërndajë informacion tek persona të paautorizuar;
  - 2.2. të mos përdorë të dhënat jashtë funksionit zyrtar;
  - 2.3. të zbatojë masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave.

**Neni 11**  
**Përgjegjësia dhe masat disiplinore**

1. Mosrespektimi i kësaj Rregullore përbën:
  - 1.1 shkelje të rëndë të detyrës zyrtare;
  - 1.2 cenim të autoritetit institucional;
  - 1.3 shkelje disiplinore.
  
2. Në varësi të natyrës së shkeljes mund të aplikohen:
  - 2.1 vërejtje me shkrim;
  - 2.2 masa disiplinore;
  - 2.3 revokim i autorizimit për trajtimin e thirrjeve;
  - 2.4 masa të tjera sipas akteve të brendshme dhe legjislacionit në fuqi.

**Neni 12**  
**Standardi institucional**

1. Autoriteti i Odës së Avokatëve të Kosovës mbrohet përmes profesionalizmit, qetësisë dhe integritetit në çdo komunikim.
  
2. Çdo zyrtar mban përgjegjësi personale për ruajtjen e reputacionit institucional.

**Neni 13**  
**Dispozita përfundimtare**

1. Kjo Rregullore është akt normativ i detyrueshëm dhe zbatohet pa përjashtim nga të gjithë zyrtarët e autorizuar të OAK.
  
2. Çdo praktikë e mëparshme që bie ndesh me këtë Rregullore shfuqizohet në momentin e hyrjes së saj në fuqi.
  
3. Interpretimi autentik i kësaj Rregullore i takon Odës së Avokatëve të Kosovës.
  
4. Mosrespektimi i dispozitave të saj përbën shkelje të rëndë disiplinore dhe trajtohet sipas akteve të brendshme dhe legjislacionit në fuqi.
  
5. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

**Prishtinë, më 06 mars 2026**  
**Rregullore Nr. 90/2026**

**Besnik R. BERISHA**  
  
**Kryetar i OAK**